



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1043/4 Prot.

Tiranë, më 09.04 2024

V E N D I M

Nr. 27 dt. 09.04 2024

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES TË  
“KËSHILLIT TË ETIKËS PËR KËRKIMIN SHKENCOR,  
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 3, 17, 33, 37 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, nenin 19, nenin 20, të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Senatit Akademik nr.106, datë 05.10.2023 “Për krijimin e një strukture të re Këshilli i Etikës për Kërkimin Shkencor, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Vendimin e Senatit Akademik nr.116 datë 14.11.2023 “Për mënyrën e kompozimit, kriteret e përzgjedhjes dhe hapjen e thirrjes për vetëkandidim të anëtarëve të Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor, në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.04.2024,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së “Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor” në Universitetin e Sporteve Tiranë (bashkëlidhur).
2. Ky Vendim t’i përcillet për njohje dhe zbatim Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor, Njësive Kryesore, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK  
KËSHILLI I ETIKËS PËR KËRKIMIN SHKENCOR

Rregullore  
“Për Organizimin dhe Funkcionimin e  
Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor,  
në Universitetin e Sporteve të Tiranës”

Tiranë, Prill 2024

## **Neni 1**

### **Baza Ligjore**

Kjo Rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Vendimit të Senatit Akademik nr.106, datë 05.10.2023 “Për krijimin e një strukture të re Këshilli i Etikës për Kërkimin Shkencor, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, të Ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe dhe të drejtat e tjera të lidhur me të”, të Ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të Ligjit 9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, , Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ndryshuar me ligjin nr.48/2012, datë 26.4.2012; me ligjin nr.120/2014, datë 18.9.2014; me ligjin nr.78/2023, datë 21.9.2023), Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor 2018, Deklaratën e Helsinkit “Parimet Etike për Kërkimin Mjekësor që përfshin subjekte humane”, të vitit 2013. Rregulloren e Këshillit të Etikës së Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe në Rregulloren për Organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

## **Neni 2**

### **Qëllimi i Rregullores**

Qëllimi kryesor, është përcaktimi i bazës ligjore dhe të një kornize vetërregulluese për ushtrimin dhe mbajtjen e përgjegjësiive ligjore, institucionale, profesionale, morale e shoqërore të personelit akademik, kërkimor shkencor dhe studentëve të UST. Gjithashtu, synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë pastërtinë dhe integritetin akademik, profesional, institucional dhe moral të veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore, në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor, sipas parimeve të Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor 2018 dhe Deklaratës së Helsinkit 2013.

## **Neni 3**

### **Objekti**

Kjo rregullore përcakton bazën për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor (KEKSH) në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Ky Këshill ka rol kryesor për të siguruar që aktivitetet kërkimore të ndërmarra në UST nga hulumtues, studentë apo palë të treta, të jenë në përputhje me legjislacionin, praktikën kërkimore dhe parimet etike të kërkimit shkencor Rregullorja e Këshillit të Etikës në Kërkimin Shkencor, përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes së studentëve dhe të personelit akademik dhe kërkues shkencor, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Universitet apo që përdorin në punimet dhe publikimet e tyre, cilësimin si pjesë përbërëse të tij.

#### **Neni 4**

##### **Përbërja e Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor**

1. Këshilli i Etikës për Kërkimin Shkencor është organ kolegjal pranë Senatit të UST-së, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit kërkimor-shkencor sipas parashikimeve të Kodit të Etikës, legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të tjera akte ligjore e nënligjore në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky Këshill përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, përkatësisht 2 (dy) përfaqësues nga Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit (IKSHS) dhe nga një përfaqësues për çdo njësi kryesore, përkatësisht 1 (një) përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes (FSLH), 1 (një) përfaqësues nga Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) dhe 1 (një) përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit (FSLH).
3. Anëtarët i përkasin kategorisë Doktor Shkencash. Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të vetëkandidimit. Këshilli i Etikës për Kërkimin Shkencor zgjedh me shumicë votash kryetarin e tij dhe i propozon Senatit Akademik për miratim Rregulloren e funksionimit të tij. Një nga anëtarët e Këshillit zgjidhet sekretar i tij.

#### **Neni 5**

##### **Mandati i antarëve të KEKSH**

1. Mandati i antarëve të Këshillit të Etikës për Kërkimin Shkencor është 2 (dy)-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Mandati i kryetarit dhe antarëve të Këshillit përfundon para kohe kur:
  - a. Ndërpret marrëdhëniet e punës me UST-në;
  - b. Për shkelje të rënda të ligjit;
  - c. Kur mungon pa arsye në 3 (tre) mbledhje radhazi të KEKSH;
  - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - e. Kur jep dorëheqjen;
  - f. Në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - g. Kur ndërrohet jetë.

#### **Neni 6**

##### **Vendimmarrja e KEKSH**

1. Mbledhjet e Këshillit quhen të vlefshme, në rast se në to marrin pjesë jo më pak se 4 (katër) e të gjithë antarëve të tij.

2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.
3. Vendimet e KEKSH mund të ankimohen në Këshillin e Etikës së UST

#### **Neni 7**

#### **Mbledhjet së Këshillit**

1. Këshilli mbledhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë në muaj.
2. Në raste të nevojshme kryetari mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme.
3. Në çdo rast lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, rendi i ditës së bashku me dokumentacionin shoqërues, bëhen nëpërmjet postës zyrtare elektronike të institucionit, të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes.
4. Procesverbali i Këshillit mbahet nga sekretari i Këshillit dhe firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
5. Sekretari ruan bllokun e procesverbaleve si dhe të gjithë dokumentacionin që ka lidhje me Këshillin.

#### **Neni 8**

#### **Detyrat dhe Funkcionet e KEKSH**

Detyra kryesore të KEKSH janë:

1. Garanto zbatimin i parimeve dhe kritereve etike të kërkimit shkencor dhe akademik në UST, që janë të detyrueshme për zbatim nga personeli akademiko shkencor dhe ëësstudentët që kryejnë kërkim shkencor në programet Master Shencor dhe Doktoratë, në kuadër të detyrimeve studimoreëë
2. Garanton respektimin dhe zbatimin e parimet dhe kritereve etike në të gjithë veprimtarinë shkencore,në kuadër të studimeve tëklit master, studimeve të doktoraturës, studimeve shkencore kërkimore, teksteve dhe botimeve që mbajnë autorëësinë e UST-sëë.
3. Formulon dhe përcakton politikat, procedurat dhe dokumentacionin e duhur, të bazuara në praktikat më të mira në lidhje me etikën dhe kërkimin shkencor dhe të sigurojë që këto politika të zbatohen brenda fushave të tij të përgjegjësisë në UST;
4. Promovon çështjet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor në UST; të bazuara në Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor 2018 dhe Deklaratës së Helsinkit 2013.
5. Monitoron zbatimin e standardeve të miratuara të etikës si dhe shqyrton dhe rishikon këto të fundit, në përputhje me zhvillimin e politikave të fushës në UST.
6. Garanton që të gjitha kërkimet shkencore që kryhen në njerëz apo kafshë të kryhen në përputhje me dispozitat kombëtare dhe ndërkombëtare për këto kërkime të referuara në këtë rregullore. Kjo përfshin dhe marjen e pëlqimit përmes nënshkrimit individual të subjekteve humane që përfshihen në kërkim, apo të kujdestarëve të tyre kur janë të mitur apo të paaftë ta bëjnë këtë. Për këto raste merret paraprakisht miratimi nga Këshilli i Etikës të UST dhe

nga çdo institucion tjetër i përfshirë, kur kërkimi kryhet në një institucion tjetër apo në bashkëpunim.

7. Në kuadër të mbrojtjes të të dhënave personale të subjekteve humane, nëse të dhënat të cilat do të mblidhen gjatë zbatimit të projekteve nuk identifikojnë subjektet e të dhënave, atëherë nuk ka pengesë ligjore për zhvillimin e tyre. Në rastet kur, gjatë zhvillimit të projekteve do të përpunohen të dhëna personale/sensitive të subjekteve të të dhënave, UST, në cilësinë e kontrolluesit, duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, duke marrë këto hapa:
  - a. të merret pëlqimi i subjekteve të të dhënave, për përpunimin e të dhënave personale për këtë qëllim, në përputhje me parashikimin e pikës 24, të nenit 3 të Ligjit;
  - b. të merren masa në drejtim të garantimit të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të nenit 18 të Ligjit (informimi mund të jetë i përfshirë në deklaratën e pëlqimit);
  - c. në kuadër të zbatimit të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të Ligjit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, të përmbush detyrimin për përditësimin për përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet plotësimit dhe dorëzimit të “Deklaratës së Ndryshimit”;
  - d. 4. të hartohet dhe miratohet një rregullore e brendshme për përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit;
  - e. të hartohen dhe nënshkruhen deklaratat e konfidencialitetit nga çdo punonjës që ka akses në të dhënat personale gjatë realizimit të projektit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit;
  - f. në cilësinë e kontrolluesit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet që Universiteti i Sporteve të Tiranës të kryejë “Vlerësimin e ndikimit në privatësi”, në zbatim dhe të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”.
8. Kontrolli e të dhënave: në zbatim të L.9887, neni 27, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është përgjegjësi e kontrolluesit (UST), nëse masat për sigurinë e të dhënave personale janë përmbushur nëse: “Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar; veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

## **Neni 9**

### **Parime të përgjithshme të KEKSH**

Këshillit, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tij, kryen veprimtarinë në përputhje me:

1. Parimin e ligjshmërisë
2. Parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit
3. Parimin e përgjegjshmërisë
4. Parimin e integritetit

5. Parimin e profesionalizmit dhe kujdesit të duhur
6. Parimin e objektivitetit dhe paanaësisë
7. Parimin e konfidencialitetit
8. Parimin e shmangjes dhe/ose eliminimit të konfliktit të inetresit
9. Kontrollon zbatimin e Deklaratës së Helsinkit 2013 në lidhje me:
  - a. Parimet e përgjithshme
  - b. Rreziqet, ngarkesat dhe përfitimet
  - c. Protokollet e rekrutimit shkencor dhe kërkimit
  - d. Komisionet e Etikës së Kërkimit
  - e. Privatësia dhe konfidencialiteti
  - f. Pëlqimi
  - g. Regjistrimi, publikimi dhe shpërndarja e rezultateve të kërkimit
  - h. Ndërhyrje të paprovuara në praktikën klinike

## Neni 10 Përkufizime

Termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si më poshtë:

1. “Bashkëautorësia” është kryerja e një punimi në grup, me më shumë se një anëtar.
3. “Fabrikimi” është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.
4. “Falsifikimi” është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i një punimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë.
5. “Kërkimi shkencor” është një ndërmarrje individuale apo e përbashkët, që synon arritje të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë.
6. “Kërkimi themelor” quhet puna origjinale teorike apo eksperimentale për përfitimin e njohurive të reja, pa pasur si synim të drejtperdrejte ndonjë zbatim apo përdorimin praktik të sajë.
7. “Kërkim i zbatuar”, quhet puna kërkimore shkencore origjinale e ndërmarrë për të zgjidhur probleme specifike të përdorimit praktik.
8. “Veprimtari kërkimore”, quhet kërkimi llogjik dhe sistematik i informacioneve të rejadhe të dobishme synim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që lindin, dhe të zgjidhjeve të problemeve në fusha të ndryshme të shkencës, nëpërmjet analizave objektive dhe përdorimit të metodologjisë së duhur shkencore.
9. “Liria akademike dhe e kërkimit shkencor” është e drejta për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme kërkimore në mënyrë të pavarur dhe pa ndikime që nuk lidhen me kërkimin.
10. “Parimet e kërkimit shkencor” janë parimet që orientojnë kërkuesit në veprimtarinë kërkimore.
11. “Përgjegjësia akademike e kërkimore” është detyrimi për të zbatuar parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikës së kërkimit në institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore.
13. “Procedurat e kërkimit shkencor” përfshijnë pyetjet kërkimore, hipotezat, analizën, formulimin e rekomandimeve, përdorimin e burimeve dhe raportimin e rezultateve të kërkimit shkencor.

14. "Sanksionet" janë masat disiplinore dhe penalizuese që merren ndaj subjekteve që kryejnë shkelje të integritetit në kërkimin shkencor.

### **Neni 11**

#### **Respekti dhe mbrojtja e të dhënave kërkimore**

1. Studentët dhe stafi akademik veprojnë në përputhje me Rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.
2. Studentët dhe stafi akademik i trajtojnë subjektet e kërkimit, me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
3. Studentët dhe stafi akademik shmangin rreziqet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet.
4. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin, mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera ligjore të aplikueshme në këtë drejtim.

### **Neni 12**

#### **Përgjegjësia individuale dhe e përbashkët**

Të gjithë autorët dhe bashkëpunëtorët në studimet kërkimore shkencore:

1. Marrin përgjegjësi për garantimin e integritetit gjatë gjithë fazave të procesit kërkimor.
2. Bien dakord qysh në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe komunikimin mbi procesin dhe rezultatet e kërkimit në mënyrë sa më transparente e të hapur.
3. Bien dakord qysh në fillim mbi standardet për integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat e trajtimit të mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljeve të dispozitave të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor.
4. Bien dakort, për publikimin apo jo për botim të të dhënave, që në fillim të kërkimit.
5. Njohin kontributin e njëri – tjetrit si bashkë – autor, në të gjitha fazat e punimit të materialit.
6. Bashkë autorët sigurojnë një nivel të barabartë të punës, me qëllim që niveli i kërkimit shkencor të jetë i saktë, transparent dhe gjithëpërfshirës.
7. Drejtuesi shkencor i akërkimeve në kuadër të studimeve Master dhe Doktoratë, ka detyrimin të drejtojë, orientojë dhe të bëjë të mundur respektimin e kërkesave të kësaj rregullore.

### **Neni 13**

#### **Shkeljet**

Shkelje përbëjnë:

1. Nxjerrja, marrja dhe publikimi i të dhënave të përdorura nga dikush tjetër.
2. Falsifikim i rezultateve të studimit.



3. Vonimi ose pengimi i punës i anëtarëve të grupit kërkimor
4. Fshehja e konfliktit të interesit

#### **Neni 14**

##### **Konstatimi dhe verifikimi i shkeljeve**

1. Në të gjitha rastet procesi i verifikimit të konstatimit fillon në Njësisë bazë, atë kryesore dhe i përcillet KEKSH nga kjo e fundit ku është realizuar/kryhet kërkimi shkencor, i mbështetur me dokumenta e evidenca shkresore
2. Pasi KEKSH, konstaton shkeljen, e merr në shqyrtim, kryen verifikimet e duhura dhe sinjalizon Departamentin përkatës, i cili vepron sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit të Etikës në UST..
3. Procedura e ndjekur nga KEKSH në raste shkeljesh është si më poshtë:
  - a. Fillon procedurat për analizimin e rastit të shkeljes.
  - b. KEKSH, kryen procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor dhe merr vendime mbi bazën e gjetjeve, në përputhje me sanksionet e parashikuara në këtë rregullore.
  - c. Në rastet kur Departamentet përkatëse nuk veprojnë në verifikimin e shkeljes, KEKSH mund të veprojë me kërkesë të dekanatit ose rektoratit.

#### **Neni 15**

##### **E drejta e interpretimit të Rregullores**

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka vetëm Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

#### **Neni 16**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pasi miratohet nga Senati Akademik.